

## **PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KOMITETIT TË PROGRAMIT BACHELOR DHE MASTER**

Datë: 19.04.2023

Takimi filloi në orën 15:30

Në takim e mbajtur me stafin akademik për nivelin e studimeve Bachelor dhe Master, të Akademisë Tempulli morën pjesë, i gjithë stafi akademik i Tempullit për tri programet (shih listën e pjesëmarrjes të bashkangjitur).

Në këtë takim u diskutuan temat sipas agjendës së takimit:

1. Mbarëvajtja e Orarit të Ligjëratave
2. Mbarëvajtja e Provimeve të Afatit të Prillit
3. Problemet eventuale dhe sfidat gjatë këtij viti akademik
4. Të tjera

Takimi u hap nga Znj. Sara Fusha Osmani, mësimdhënëse dhe Menaxhere Operative e cila pasi ju shprehi mirëseardhje të pranishmëve i njoftoj të njëjtit për agjendën dhe qëllimin e takimit.

Qëllimi i takimit ishte mundësia e një vizite nga Agjenci e Kosovës për Akreditim – AKA, e cila mund të ndodhë në ditët në vijim dhe do të jetë pa paralajmërim, andaj ju njoftojmë se duhet të jeni të përgatitur për një vizitë të tillë, në mënyrë që të jemi në rregull me të gjitha procedurat dhe proceset e mbarëvajtjes së mësimin, sidomos në oraret e ligjëratave, të publikuar në webfaqen e Akademisë, pasi vizita eventuale nga AKA, do të bazohet në orarin e publikuar, kështu që duhet të jemi të vëmendshëm që në këtë rast ti njoftojmë përfaqësuesit e AKA, sipas orarit të publikuar të ligjëratave dhe ushtrimeve apo praktikave të cilat janë të parapara të mbahen me studentë në institucione të ndryshme të cilat lidhen me lëndë përkatëse.

Më pas fjalën e morri z. Mevlan Bixhaku, koordinator i programit Master, i cili po ashtu foli për mundësin dhe rendësin e një vizite të papritur të AKA-a, andaj kërkoje nga kolegët që të jenë të vëmendshëm gjatë ditëve në vazhdim, dhe ligjëratat dhe ushtrimet të mbahen sipas orarit të publikuar në webfaqe.

Lidhur me oraret për nivelin bachelor të pranishmeve ju drejtua Adem Selmani koordinator i nivelit bachelor, duke i njoftuar të pranishmit lidhur me orarin e ligjëratave, ushtrimeve si dhe praktikat të cilat po mbahen dhe do të vazhdojnë të mbahen në vazhdimësi nga studentët së bashku me mësimdhënësit e lëndëve përkatëse.

Diskutimet tjera u zhvilluan në frymën e agjendës së paracaktuar, ku secili nga të pranishmit – ligjëruesit u deklaruan veç e veç për pikat e agjendës.

1. Lidhur me mbarëvajtjen e orarit të ligjëratave të gjithë të pranishmit u deklaruan se nuk kishte ndonjë problem të theksuar gjatë ligjëratave dhe se çdo gjë ishte duke shkuar në mënyrë normale sipas planit dhe dinamikës së paraparë.
2. Lidhur me mbarëvajtjen e provimeve për afatin e jashtëzakonshëm të Prillit nuk pati ndonjë vërejtje, apo shqetësim, dhe se deri tani mbarëvajtja ka qenë në rregull, dhe se pritet të vazhdojë në të njëjtën mënyrë deri në përfundim të afatit.
3. Lidhur me pikën e tret, nuk pati ndonjë diskutim apo koment pasi asnjë nga të pranishmit nuk pati të deklarojë ndonjë problem apo sfidë gjatë kësaj periudhe akademike.
4. Në pikën ndër të tjera, fjalën e morri sekretarja e Akademisë Znj. Fatime Krasniqi, e cila ngriti çështjen e vijueshmëri së studentëve në ligjërata, në të gjitha nivelet, pasi numri i studentëve të cilët vijnë ligjëratat dhe ushtrimet është shumë i ulët, dhe kërkoi mendimin dhe sugjerime eventuale nga të pranishmit, se si të veprohet në mënyrë që të rritet numri i studentëve në ligjërata. U diskutuan disa mënyra se si të mund të nxiten studentët që të marrin pjesë më shumë në ligjërata, duke u munduar të joshen me pikë apo me rritjen e notës në provimeve nëse pjesëmarrja e tyre në ligjërata është më e rregullte. Diskutime pati edhe për vizita praktike – studimore në institucione të ndryshme me studentë, gjatë javëve në vijim, ku secili mësimdhënës duhet të parashih dhe ti përgatisë së bashku me studentët vizita të tilla, në institucione përkatëse në përputhje me lëndën përkatëse të cilën ata e ligjërojnë.

Takimi u mbyllë në ora 17:30

Procesverbalin e mbajti:

MSc. Adem Selmani  
*Adem Selmani*